

Programi për trajnimin e trajnuesve

9. Programi për trajnimin e trajnuesve

Bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, trajnuesit janë të detyruar të marrin pjesë në programet për trajnim të trajnuesve, duke pasur parasysh se ata janë faktorë kyç për cilësinë dhe zbatimin e programeve trajnuese. Në funksion të kësaj, Akademia aplikon standarde sa i përket përzgjedhjes së trajnuesve si dhe trajnime për trajnues për ngritjen e kapaciteteve prezantuese.

Si rezultat i këtij programi trajnues synohet:

- Avancimi i metodologjisë trajnuese;
- Ngritja e aftësive dhe strategjive të mësimdhënies;
- Vazhdimi i edukimit gjyqësor;
- Mbajtja dhe përmirësimi i kompetencës profesionale dhe interdisiplinare të përfituesve të Akademisë;
- Reformimi i programeve trajnuese.

Përmes Programit për trajnimin e trajnuesve Akademia e Drejtësisë do të ofrojë nivelin më të lartë të trajnimit teorik dhe praktik, duke krijuar dhe mbajtur trajnues të përditësuar me metodologjitë trajnuese bashkëkohore me qëllim të realizimit të trajnimeve sa më atraktive, praktike dhe efektive për të përmbushur synimet e përcaktuara në programin trajnues.